

DEKOSIL

Llak(lyerës)i dukshëm në bazë metakrilati për impregnimin e sipërfaqeve të çimentos dhe gurit

I përgjigjet EN 1504-2:2004: 5.1 (C)

FUSHA E APLIKIMIT

Lyerës i dukshëm mbrojtës për sipërfaqe dyshemesh dhe muresh, që jep pamje të shndritshme dhe të lagësht. Përdoret si llak për impregnimin dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë fizike të sipërfaqeve të çimentos dhe gurit. Përdoret për përpunimin final të bazave të betonit me strukturë të mbyllur si Poding K dhe beton të shtypur që nuk u ekspozohen ndikimeve të jashtme, lagështisë, temperaturave të ulëta dhe kripërave për shkrirje. Dekosil-i krijon film, i cili nuk e lëshon avullin dhe nëse ka avull të mbetur brenda bazave të betonit, mund të vijë deri te qërimi i tij.

CILËSITË

- Lyerje një-komponentëshe e pa ngjyrë
- E mbyll strukturën sipërfaqësore dhe i përmirëson veçoritë fizike e mekanike të bazës
- Ad-hezion i shkëlqyeshëm;
- I rezistueshëm ndaj ujit;
- E shton rezistencën ndaj thërmitjes(shkërmoqjes së strukturës);
- Shpenzime të vogla;
- Përdorim(realizim) i thjeshtë.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Pamja	-	Lëngu(solucioni) i dukshëm i viskozës
Dendësia	EN ISO 2811-1	0,92-0,98g/cm ³
At-hezioni i bazës	EN 1542	≥ 2,0MPa
Absorbimi kapilarik	EN 1062-3	w≤0,1kg/m ² h ^{0,5}
Rezistenca abrazive	EN ISO 5470-1	< 3000mg
Rezistenca ndaj goditjeve	EN ISO 6272-1	klasi II ≥10Nm
Koha e tharjes në temperaturë 20°C		
Sipërfaqësisht, në prekje	metodë interne	60min
Tharje e tërësishme	metodë interne	150min
Temperatura e bazës dhe ajrit gjatë përdorimit(futjes në ndërtim)	-	5-35°C
Lagështia relative e ajrit	-	<70%
Përdorimi mekanik për transport të lehtë dhe të rëndë në 20°C	-	pas 3 ditësh
Rezistenca ndaj agresionit(procesit) të butë kimik		Pas 7 ditësh

METODOLOGJIA E APLIKIMIT

PËRGATITJA E BAZËS

Baza për hedhjen e Dekosil-it duhet të jetë e shëndoshë, e thatë, e pastër, e payndyrshme, pa pluhur, pa pjesë labile e kondenzat, me lagështi maksimale prej 7% dhe të jetë e rezistueshme ndaj tretësve. Temperatura e ajrit dhe bazës duhet të jetë 5-35°C, kurse lagështia relative e ajrit <70

Baza e re e betonit

Betoni duhet të jetë i vjetër së paku 28 ditë dhe të ketë fortësi minimale prej 25MPa me lagështi maksimale prej 7%. Çimentoja e holluar("qulli i çimentos"), mbetjet e llaçit, ngjyrës dhe vajit, duhet të mënjahen në mënyrë mekanike ose me anë të mjeteve kimike. Nëse përdoren materie kimike, baza duhet rrënjësisht të shpëlahet me ujë. Në fund, baza duhet të pastrohet nga pluhuri me thithëse industriale të pluhurit.

Baza e vjetër e betonit

Baza duhet të jetë e shëndoshë dhe e pastër, në mënyrë që të arrihet at-hezion i shkëlqyeshëm dhe të ketë fortësi minimale të presionit 25MPa dhe lagështi maksimale prej 7%. Çimentoja e holluar("qulli...") duhet të hiqet në mënyrë mekanike. Yndyrat(vajrat) dhe papastërtitë që kanë depërtuar në bazë, duhet të mënjahen me anë të detergjenteve ose aparateve speciale për këtë qëllim dhe pastaj baza rrënjësisht duhet të shpëlahet me ujë. Nëse ka dëmtime të bazës, ato duhet të sanohen me materiale përkatëse për sanim. Nga baza finale pluhuri duhet të mblidhet me thithëse industriale të pluhurit.

Betoni presues(i shtypur)

Betoni presues(i shtypur) duhet të jetë të paktën 28 ditë i vjetër dhe të ketë fortësi minimale të presionit 25MPa. Për shkak të përdorimit të pudrës dhe vajrave veshëse(mbështjellëse), gjatë përpunimit të tyre, nevojitet pastrimi rrënjësor i sipërfaqeve. Këto mjete(substanca) e pengojnë lidhjen e Dekosil-it me bazën. Para hedhjes, sipërfaqja duhet të pastrohet me acid të holluar e pastaj të pastrohet rrënjësisht me ujë. Aplikimi i Dekosil-it bëhet të paktën 24 orë pas heqjes së pudrës, me ç'rast lagështia maksimale e bazës duhet të jetë nën 7%. Dekosil-i është llak që nuk e lëshon avullin, për çka në sipërfaqe të hapura e më të mëdha, nën bazën e betonit nevojitet hidroizolim që s'e lëshon avullin.

APLIKIMI(FUTJA NË PËRDORIM)

Për impregnim

Gjatë përdorimit të Dekosil-it për impregnim, varësisht nga poroziteti i bazës, prodhimi hollohet me 5-15% tretës P. Hedhja(shtresimi) bëhet me lyerjen e bazës me furçë, rul(maq.: "valjak"), ose me aparat me spërkatjen në një shtresë.

Si llak(lyerës)

Dekosil-i futet në përdorim me lyerjen e bazës me furçë, rul ose me aparaturë me anë të spërkatjes në një shtresë. Materiali mund të hollohet 5% me Tretësin P. Sipërfaqet e përpunuara duhet të mbrohen nga korenti i ajrit("shkuja") dhe pluhuri në periudhë prej 12 orësh pas hedhjes.

SHPENZIMI

Për impregnim, për një shtresë - 0.15-0.2kg/m²

Si llak(lyerës)për një shtresë: 0,15-0,3 kg/m², varësisht nga poroziteti i bazës

PASTRIMI

Veglat dhe mjetet tjera pastrohen me Tretësin P menjëherë pas përdorimit.

PAKETIMI

Kanta metalike prej 3kg dhe 15kg

RUAJTJA

Ruhet në ambalazhin origjinal të mbyllur, në temperaturë prej 5-35°C, të mbrojtur nga rrezet e diellit dhe nga ngrirja. Afati i përdorimit: 9 muaj.

SHENJË PËR PRODHIM TË ÇERTIFIKUAR

 2032	
ADING SHA Shkup	
Novoselski pat(rr.1409) nr.11	
1060 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut	
17	
GKDA001/6	
EN 1504-2:2004	
DEKOSIL	
Llak(lyerës) për mbrojtje sipërfaqësore dhe rritje të qëndrueshmërisë së shtresave të betonit	
Fortësia ad-hezive me test pull-off	$\geq 2,0 \text{ N/mm}^2$
Absorbimi kapilarik	$w < 0.1 \text{ kg/m}^2 \cdot h^{0.5}$
Qëndrueshmëria ndaj abrazionit	$< 3000 \text{ mg}$
Qëndrueshmëria ndaj goditjeve	Klasi II $\geq 10 \text{ Nm}$ Pa plasaritje dhe delaminim
Reagimi ndaj zjarrit	Euroklasi F
Substanca të rrezikshme	Veçoria nuk është e përcaktuar

LYERJE MBROJTËSE

Rreziku për jetë: Duhet të evitohet kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë si dhe të thithjes së drejtpërdrejtë përmes frymëmarrjes. Në rast të kontaktit të paqëllimtë, prodhimi duhet të mënjanoher menjëherë me leckë të thatë ose të lagur pak me Tretësin P, e pastaj të shpëlahet me ujë të pastër dhe sapun. Nëse materiali spërkat sytë, sytë duhet të shpëlahen me ujë të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Po ashtu nevojitet që të ajrosen hapësirat ku punohet me rrëshira dhe tretës.

Kundrejt zjarrit: Prodhimi mund të ndizet.

Pastrimi dhe ruajtja: Mbetjet e shpërndara të Dekosilit mund të pastrohen me Tretësin P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të ruhet sipas rregullave lokale për këtë lloj mbeturinash.

Rekomandojmë që sasisë e nevojshme gjatë në procesin ndërtues të adaptohen sipas kushteve të objektit si dhe të përdoren domosdo pajisje përkatëse.